

Dita botërore në kujtim të viktimave nga aksidentet rrugore

18 Nëntor 2013

Aksidentet nga trafiku rrugor vrasin afërsisht 1.3 milion njerëz çdo vit dhe dëmtojnë më shumë se 50 milion të tjerë. Ato janë shkaku kryesor i vdekjeve për moshat e reja 15-29 vjeç.

Në tetor 2005, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë, në të cilën i bëhej thirrje qeverive që ta kujtonin çdo vit të dielën e tretë të muajit nëntor si dita botërore në kujtim të viktimave nga aksidentet rrugore. Kjo ditë u krijua si një mjet për të njohur viktimat e trafikut rrugor si dhe shqetësimet e të afërmeve të tyre të cilët duhet të përballen me pasojat emocionale të këtyre ngjarjeve tragjike.

Në këtë ditë në të gjithë botën inkurajohen qeveritë dhe organizatat jo-qeveritare për ta përkujtuar këtë ditë si një mjet për të tërhequr vëmendjen e publikut për aksidentet nga trafiku rrugor, pasojat e tyre, shpenzimet, si dhe masat që mund të merren për të parandaluar ato.